


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.07.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2024-14 për z.Faik Grainca – Drejtor i Departamentit të Urbanizmit – Komuna e Ferizajit, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-2024-14, për Zyrtarin e lartë, z.Faik Grainca – Drejtor i Departamentit të Urbanizmit – Komuna e Ferizajit dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Faik Grainca fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z-D/DPK-01-2236/14), pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Grainca është deklaruar do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Grainca, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar një shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-2520-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, N.T.P."FG-COM", z.Grainca, pronar i biznesit, ka emruar një "person të besuar" në funksionin e personit të autorizur, ashtu siç e parasheh edhe ligji, duke parandaluar kështu konfliktin e interesit me funksionin e tij publik–Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Ferizajit.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

